



**Prishtinë, 12 tetor 2012**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_457\_2012**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 8 paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, Nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2, Nenin 25 dhe Nenin 34 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185);
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafi 3, nënparagrafi 3.1 dhe Nenit 33 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë,

**në seancën e mbajtur me datë 12 tetor 2012, nxori këtë:**

## **VENDIM**

- I. MODIFIKOHET Licenca për Furnizim Publik të ngrohjes qendrore (me kushte) e dhënë Ndrohtores së Qytetit Termokos Sh.A” – me numër licence ZRRE/Li\_12/06.**
- II. Licenca e modifikuar (tani e tutje “Licencë për Furnizim Publik të Ngrrohjes Qendrore”) me numër licence ZRRE/Li\_12/12 do të hyjnë në fuqi në datën e nxjerrjes së këtij vendimi dhe do të jetë e vlefshme deri me datë **04.10.2036**. Obligohet Ndërmarrja Publike “Termokos” SH.A. që të zbatojë të gjitha dispozitat e licencës së modifikuar.**

## **Arsyetim**

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) në dhjetor të vitit 2011 ka filluar procedurën për modifikim të licencës për furnizim publik të ngrohjes qendrore Ndërmarrja Publike “Termokos” SH.A., të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së me datë 04.10.2006. Modifikimi ka filluar në pajtim me Nenin 34 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, si rrjedhojë e ndryshimit të ligjeve në sektor të energjisë.
  - Me 27 janar 2012 ZRRE ka publikuar në ueb faqen e saj draft – licencën e sipërpërmendur për komente nga palët e interesuara. ZRRE ka marrë parasysh edhe komentet e palëve të interesuara dhe përfundimisht ka harmonizuar dispozitat e kësaj licence me legjislacionin primar dhe sekondar në sektor të energjisë.
  - Duke marrë parasysh këtë që u tha më lartë dhe mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ZRRE ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.**



**IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

*\*Bashkëngjitur licenca e modifikuar.*

Vendimi i dërgohet:

- Ngrohtores së Qytetit Termokos Sh.A
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar